



KËSHILLI I BASHKISË VAU DEJËS

PROCES VERBAL

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejës për muajin Prill 2025

Data 28.04.2025 ora 14:00.

Mbledhja zhvillohet në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat.

Rendi i dites:

1.Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.03.2025, 08.04.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

2.Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2025..

3.Projekt vendim mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, Datë 26.03.2025, Dhe Këshillit të Qarkut Shkoder Nr.200 Prot, Datë 26.03.2025 “Për Bashkëpunim Ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit “Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë ,Bashkia Vau Dejës”

4.Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës “Vkb-në Nr.84 Datë 23.12.2024” Sipas akt marrëveshjes Nr.1429 Datë 26.03.2025, ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës.

5.Projekt vendim mbi miratimin e sistemit të pikëzuar për programin e strehimit social.

6.Të ndryshme.

Grupe interesi nuk kishte prezent në mbledhje.Votimet do bëhen të hapura.

Mbledhja e rradhës e Këshillit Bashkiak Vau Dejes për muajin Prill 2025, u zhvillua me datë 28.04.2025 ora 14.00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak Njësia Administrative Bushat. Fillimisht u bë apeli i këshilltarëve që ishin prezent në sallë, nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak, Z.Ardian Çelepija.Të pranishëm në sallë ishin 22 këshilltarë, (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj,Pjeter Lleshi.Florin Tanushi,Ferdinand Fusha,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga, Albina Livadhi,Ermir Tahiri, Samed Hasmegaj) korum i mjaftueshëm dhe i nevojshëm për të zhvilluar mbledhjen e këshillit.

Fjalën për të filluar mbledhjen e mori Z.Frano Prenga -zv/kryetar i këshillit bashkiak i autorizuar nga Kryetari K.B z.Ervis Shimaj, i cili lexoi rendin e dites dhe pyeti këshilltarët nëse ishin dakort me rendin e ditës.Këshilltarët shprehen dakortësi.

Z. Frano Prenga e hedh në votim rendin e ditës:

Miratohet me 22 vota Pro, zero vota kundër, zero vota abstenim.



Këshilltarët që votuan Pro rendin e ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornella Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Vjollca Markolaj, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Pjeter Lleshi, Florin Tanushi, Ferdinand Fusha, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Samed Hasmeqaj)

Z.Frano Prenga lexon piken e parë të rendit të ditës:

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes datë 26.03.2025, 08.04.2025 dhe informacion për VKB-të e marra në këtë mbledhje.

U pyeten këshilltarët nëse ishin dakort me procesverbalin e mbledhjes së datës 26.03.2025 dhe datës 08.04.2025 nga Z.Frano Prenga. Këshilltarët nuk kishin pyetje dhe të gjithë shprehen dakortësi për miratimin e tij.

Z.Frano Prenga lexon piken e dytë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Mars 2025

Z.Frano Prenga fton për të relatuar Znj. Elidona Lisi – perfaqesuese e zyres ndihmes ekonomike, e cila relaton lidhur me projekt vendimin e paraqitur. Ajo shprehet se bazuar në fondet e kushtëzuara për muajin Mars 2025, familje 134, me 450,262 lekë, me 5.98% e fondit total.

Në total për Bashkinë Vau Dejës, për Muajin Mars 2025 janë shpallur fitues, 986 familje, me fond 7,574,212 lekë, nga ku 6% e këtij fondi është 454,452 lekë.

Z.Frano Prenga fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 22 vota Pro. zero kundër dhe zero abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e dytë të rendit të ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornella Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Vjollca Markolaj, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Pjeter Lleshi, Florin Tanushi, Ferdinand Fusha, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Samed Hasmeqaj)

Z.Frano Prenga lexon piken e tretë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, Datë 26.03.2025, Dhe Këshillit të Qarkut Shkoder Nr.200 Prot, Datë 26.03.2025 "Për Bashkëpunim Ndërvendor në fushën e shërbimeve publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rrugës së varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës"

Z.Frano Prenga fton për të relatuar Znj. Elsa Tanushi përgjegjëse e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se projekt vendimi ka për qëllim miratimin e Marrëveshjes së bashkëpunimit mes Bashkisë Vau Dejës Nr.1429 Prot, datë 26.03.2025, dhe Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.200 Prot, datë 26.03.2025 "Për Bashkëpunim ndërvendor në fushën e Shërbimeve Publike për kryerjen e investimit "Rikonstruksion i Rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau



Dejës".Miratimi i marreveshjes i hap rruge edhe projekt vendimit te shteses se Buxhetit te Bashkisë miratuar sipas VKB nr 84 datë 23.12.2024 "Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës", dhe Shprehje Ligjshmerie nga Prefektura Shkodër me nr 860/1 prot datë 06.01.2025 shtohet me vlerën prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekësh, dhe zerin e investimit "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushe" Bashkia Vau Dejës, ne programin 04520 dhe kod produkti 1570859.

Z.Frano Prenga fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 22 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e tretë të rendit të ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj,Rita Preçi,Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha,Kastriot Shkjau, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Majlinda Ndreca,Besmir Kapaj,Pjeter Lleshi.Florin Tanushi,Ferdinand Fusha,Arsen Mehmeti,Roberto Trushi,Frano Prenga, Albina Livadhi,Ermir Tahiri, Samed Hasmegaj)

Z.Frano Prenga lexon piken e katërt të rendit të ditës:

Projekt vendim për shtesën e buxhetit të Bashkisë Vau Dejës "Vkb-në Nr.84 Datë 23.12.2024" Sipas akt marrëveshjes Nr.1429 Datë 26.03.2025, ndërmjet Këshillit të Qarkut Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës.

Z.Frano Prenga fton për të relatuar Znj.Elsa Tanushi pergjegjese e zyres financë buxhetit Bashkia Vau Dejës e cila relatoi se ky projekt vendim ka për qëllim shtesën e buxhetit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr 84 datë 23.12.2024 'Miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm perfundimtar 2025 2027, numrin e punonjësve të Bashkisë Vau Dejës".

Me zbatimin e buxhetit te vitit 2025 ka lindur nevoja për shtesën e buxhetit të bashkisë për arsye të Akt Marreveshjes nr 1429 Prot date 26.03.2025 "Për Bashkepunim ndervendor ne fushen e Sherbimeve Publike per kryerjen e investimit "Rikonstruksion i rruges së Varrezave Melgushë", Bashkia Vau Dejes. Shuma prej 12,000,000 (dymbëdhjetë milion) lekë e planifikuar nga Transferta e Pakushtëzuar e vitit 2025 dhe nga fondet e trashëguara nga viti 2024, bën menjëherë transferimin e kësaj shume tek Bashkia, për kryerjen e investimit me objekt: "Rikonstruksion i rrugës së Varrezave Melgushë, Bashkia Vau Dejës".

Këshilli i Qarkut ka kryer procedurën e transferimit të fondeve sipas pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Shkodër Nr.6 datë 13.03.2025.

Z.Frano Prenga fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 22 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.



Këshilltarët që votuan Pro piken e katërt të rendit të ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Pjeter Lleshi, Florin Tanushi, Ferdinand Fusha, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Samed Hasmegaj)

Z.Frano Prenga lexon piken e pestë të rendit të ditës:

Projekt vendim mbi miratimin e sistemit të pikëzuar për programin e strehimit social.

Z.Frano Prenga fton për të relatuar Z.Edmond Gjeçaj- specialist i strehimit social i cili relaton për Këshilltarët se në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 për " Strehimin Social", i ndryshuar, përzgjedhja e subjekteve dhe familjeve përfituese bëhet nëpërmjet një Sistemi Pikëzimi i cili miratohet për çdo program nga njësia e vetëqeverisjes vendore bazuar në kriteret e përcaktuar me ligj.

Bazuar në nenin 15 të ligjit Nr. 22/2018 i ndryshuar për "Strehimin Social" u diskutua mbi sistemin e pikëzimit i cili do aplikohet në zbatim të programit të strehimit "Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme" si dhe për "Sistemin e pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë" për vitin 2025.

Bazuar në ligjin Nr.22/2018 i ndryshuar "Për Strehimin Social" neni 16 "Kriteret e përzgjedhjes së përfituesve, "Programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese dhe zonave të papërshtatshme" dhe "Sistemi i pikëzimit për trajtimin sipas programit të subvencionit të qirasë në tregun e lirë". Bazuar gjithashtu në problemet sociale dhe nevojave të shfaqura në territorin e Bashkisë Vau Dejës, Komisioni i Strehimit prane Bashkisë është dakortësuar mbi vendosjen e përparësive në pikëzim të kategorive të vendosura në prioritet sipas ligjit.

Z.Frano Prenga fton këshilltarët nëse kanë pyetje apo diskutime.

Këshilltarët nuk kishin pyetje apo diskutime.

Z.Frano Prenga e hedh në votim projekt vendimin:

Miratohet me 22 vota Pro.zero kundër dhe zero abstenim.

Këshilltarët që votuan Pro piken e pestë të rendit të ditës (Franga Kola, Leonora Prenga, Neki Kapllanaj, Rita Preçi, Ornela Lleshi, Mirela Vasija, Meliha Zyberaj, Mark Bisha, Kastriot Shkja, Vjollca Zagani, Violetë Markolaj, Majlinda Ndreca, Besmir Kapaj, Pjeter Lleshi, Florin Tanushi, Ferdinand Fusha, Arsen Mehmeti, Roberto Trushi, Frano Prenga, Albina Livadhi, Ermir Tahiri, Samed Hasmegaj).

Pika 6: Të ndryshme.

Z.Frano Prenga fton këshilltarët për të diskutuar problemet dhe shqetësimet që mund të kenë, drejtuar zv.Kryetarit të Bashkisë Z.Ervis Molla i cili është prezent në mbledhje.

Këshilltarët të kjo pikë e rendit të ditës nuk ngriten shqetësime apo probleme kundrejt zv.Kryetarit të Bashkisë si dhe nuk kishin hasur ndonjë shqetësim të banorët që ato përfaqësojnë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Drejtuesi i mbledhjes së këshillit e deklaron të mbyllur mbledhjen e datës 28.04.2025.

Mbajtësi i Protokollit

Sekretari Këshillit

Ardian ÇELEPIJA



Këshilltarët:

1. Neli Kopllanaj
2. Melike Zyber
3. Frangor Turo
4. Neno Frejza
5. Ornela Lleshi
6. Mylindole Vdew
7. Leonora Roderger
8. Hiron Jonuzhi
9. Pjeter Reshi
10. Violeeta Markolaj
11. Emir Tohiri
12. Kastriot Shkiperi
13. Arsen Mehmeti
14. Vjollcë Zogou
15. Allina Livadhi

16. Rita Gresi
17. Kirela Vasija
18. Roberto Kosh
19. Ferdinand Gusha
20. Demir Kopej
21. Ilirida Bisu
22. Samed Husein
23. _____
24. _____
25. _____
26. _____
27. _____
28. _____
29. _____
30. _____
31. _____